



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORÇE

Vendim
Nr. 28 datë 14/04/2010

Për fillimin e procedurave, për dhënien me qira te truallit me sipërfaqe prej 400 m², të ndodhur ne zonën e ish “Kampit te Punëtorëve “, pranë depos se ujit .

Këshilli Bashkiak Korçe pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe mbështetur në nenin 32 pika e të ligjit 8652 dt 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionim e qeverisjes vendore”, V.K.M-se nr.1712, date 24.12.2008 “Per dhenien me qira ose enfiteoze te pasurive shtetërore” te ndryshuar, udhezimit e Ministrise, te Ekonomise, Tregëtisë dhe Energjitikes , Nr.316 date 08.04.2009 “Për zbatimin e V.K.M-se nr .1712, date 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiteoze te pasurive shtetërore”, V.K.M-se nr.1532 date 19.12.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave te paluajtshme publike shtetërore qe transferohen, ne pronesi, ose ne perdorim, te Bashkise Korçe te qarkut te Korçes ,si dhe mbas diskutimeve te Këshilltarëve :

VENDOSI:

1. Të fillojnë procedurat për dhënin me qira ,me anë te konkurrimit te truallit me siperfaqe prej 400 m², të ndodhur ne zonën e ish “Kampit te Punëtorëve “, pranë depos se ujit ,për veprimtari ekonomike, në fushën e telefonisë celulare .
2. Afati per dhënin me qira do te jete 9 vjet .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari
Gjergji PENDAVINJI